

# Kolegji rrëzon ankimin e ish-gjyqtarit Luan Dervishi

Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendosi unanimitisht të lërë në fuqi vendimin e Komisionit për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit Luan Dervishi për fshehje pasurie dhe mungesë profesionalizmi.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Gjyqtari i Apelit të Shkodrës, Luan Dervishi dhe avokati Ardian Visha gjatë seancës dëgjimore në KPK. Foto: Malton Dibra/LSA

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, KPA vendosi të enjten rrëzimin e ankimit të kryer nga gjyqtari i Apelit Shkodër, Luan Dervishi ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KPK për shkarkimin e tij nga detyra.

Në njoftimin e KPA thuhet se trupi gjykues i Kolegjit, i përbërë nga Ardian Hajdari kryesues, Sokol Çomo relator, Albana Shtylla, Ina Rama dhe Natasha Mulaj anëtarë, pasi e shqyrtuan ankimin në dhomë këshillimi, vendosën në mënyrë unanime lënien në fuqi të vendimit të KPK për ish-gjyqtarin Luan Dervishi, duke e larguar përfundimisht nga sistemi i drejtësisë.

Luan Dervishi u shkarkua nga detyra më 26 nëntor 2018, pasi u identifikuan probleme të shumta në deklaratimet e pasurive dhe mungesë profesionalizmi. Nga hetimi administrativ u konkluduan deklaratime të pasakta; fshehje e pasurive dhe mungesë e burimeve të ligjshme për justifikimin e tyre; deklaratime të rreme e konflikt interesi.



**RRETH AUTORIT**

### **Edmond Hoxhaj**

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.